



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 10.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 07.08.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “BERISHA COM” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Doblibare, Berdosanë, Vraniq dhe Rezinë”, Nr. i prokurimit- 632-23-6334-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-084-521, nxjerr:

### V E N D I M

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “BERISHA COM” SH.P.K., e dt.07.08.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Doblibare, Berdosanë, Vraniq dhe Rezinë”, Nr. i prokurimit- 632-23-6334-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-084-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 01.08.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Anulohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 01.08.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që lëndën ta kthej në ri-vlerësim;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## Ar sy e t i m

Me dt.07.08.2023, Operatori Ekonomik “**BERISHA COM**” SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “**Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Doblibare, Berdosanë, Vraniq dhe Rezinë**”, Nr. i prokurimit- 632-23-6334-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-084-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 10.08.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron, sepse sipas FDT-së, është kërkuar një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, që dmth se Operatori Ekonomik ka sjellur marrëveshjen për pagesë të borjeve tatimore me këste.

Pretendimi juaj i dytë është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi juaj i tretë nuk qëndron, sepse sipas FDT-së, janë kërkuar të ketë të përfunduara me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Në një vlerë prej jo më pak se 220.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjajshme që dmth se Operatori Ekonomik ka referenca të mjaftueshme për punët e kryera.

Pretendimi juaj i katër dhe i gjashtë nuk qëndron, sepse sipas FDT-së, nuk është kërkuar që të jetë i detajuar dhe nuk ka pasur prag të planit dinamik (afat minimal dhe maksimal).

Pretendimi juaj i pestë nuk qëndron, sepse marrëveshja e prezentuar nga Operatori Ekonomik për qira të paisjeve është mjaftueshëm bindëse për Autoritetin Kontraktues.

Pretendimi juaj i shtatë nuk qëndron, sepse sipas FDT-së, janë kërkuar të ketë qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 290.000,00€, gjatë tre viteve të fundit, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit që dmth se Operatori Ekonomik i ka sjellur raportet financiare.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.



**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Të gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës